



# Buletini Mjedisor

## VIJNË NË GJUHËN SHQIPE REKOMANDIMET E MASTRIHTIT



Ministria e Mjedisit me financim të OSCE-së, prezenca në Shqipëri, mundësuan sjelljen në gjuhën shqipe të Rekomandimeve të Mastrohitit për Promovimin e Pjesëmarrjes së Efektshme të Publikut në Vendimmarrjen për Çështjet Mjedisore.

Ky publikim u mundësua nga Grupi i Punës për Pjesëmarrjen Publike në Vendimmarrje sipas Konventës për Aksesin në Informacion, Pjesëmarrja e Publikut në Vendimmarrje dhe Aksesin në Drejtësi për Çështjet Mjedisore. Gjithashtu ky publikim u hartua në përgjigje të kërkesës së Takimit të Palëve të Konventës, pas thirrjeve disavjeçare të zyrtarëve dhe pjesëtarëve të publikut për udhëzime më praktike rreth mënyrës se si mund të përmirësohet zbatimi i dispozitave të Konventës për Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje.

Ministria e Mjedisit ka mundësuar në 2011 një sërë udhëzuesish në përputhje me legjislacionin kombëtar për të drejtën për të pasur informacion mjedisor; udhëzues për bizneset dhe autoritetet publike, se cilat janë detyrimet e tyre në kuadër të Konventës së Aarhusit dhe në veçanti për të tërhequr mendimin e publikut në vendimmarrjen mjedisore.

Gjithsesi tashmë publikimi i Rekomandimeve të Mastrohitit u përgatit nëpërmjet një procesi të hapur dhe me pjesëmarrje të gjërë. Përveç pikave fokale të Konventës dhe grupeve të saj të interesit, projekt rekomandimet u dërguan për komente dhe pikave fokale dhe grupeve të interesit të Konventës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor në Kontekst

Ndërkufitar dhe Konventës për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhjeve Ndërkufitare të Ujit dhe Liqeneve Ndërkombëtare.

Rekomandimet e Mastrohitit bazohen në praktikën e mira ekzistuese dhe synohen që të jenë mjete praktike për përmirësimin e zbatimit të dispozitave të Konventës për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje që përdoren në dy mënyra:

Për të ndihmuar Palët gjatë hartimit të kuadrit të tyre ligjor për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen për mjedisin sipas kësaj Konvente;

Për të ndihmuar zyrtarët publikë gjatë punës së tyre të përditshme kur hartojnë dhe kryejnë procedurën të pjesëmarrjes së publikut në lidhje me vendimmarrjen për mjedisin sipas kësaj Konvente.

Gjithashtu, Rekomandimet mund t'i shërbejnë publikut, përfshirë organizatat jo-qeveritare dhe sektorin privat, për t'ë njohur eksperiencat e tyre ata mund të bëhen pjesë në vendimmarrjet për çështje mjedisore.

Rekomandimet ofrojnë udhëzime të dobishme për zbatimin e neneve 6, 7 dhe 8 të Konventës, veçanërisht për mënyrën se si të trajtohen disa sfida kyçe të evidentuara nga Komisioni i Përpunshëmrisë së Konventës e Aarhus-it dhe nga të tjerët palë të interesuar. Ato nuk janë as të detyrueshme dhe as

shteruese dhe në varësi të rekomandimit dhe diapazonit të gjerë të rrethanave në terrioret e Palëve të ndryshme, ato nuk janë detyrueshme e vetmia mënyrë për të pasur përputhshmëri me Konventën. Ndërsa Rekomandimet nuk janë interpretim zyrtar i Konventës, ato shërbejnë si mjet i nevojshëm me anë të të cilit mund të ndahet ekspertizë dhe praktikë më të mira dhe të ndihmohen politikëbërësit, legjislatorët dhe autoritetet publike në punën e tyre të përditshme për zbatimin e Konventës.

Për të ndihmuar zyrtarët që kryejnë procedurën të pjesëmarrjes së publikut sipas Konventës, këshillohet që Rekomandimet e Mastrohitit të përkthehen në gjuhë kombëtare përkatëse, dhe në varësi të burimeve, zyrtarëve tu ofrohet trajnim rreth përdorimit të tyre. Kjo ishte arsyeja pse keto rekomandime u sollën dhe në gjuhën shqipe.

Ministria e Mjedisit ka publikuar në faqen zyrtare të saj dhe jua ka shpërndarë në rrugë elektronike shoqatave mjedisore, por në një të ardhme të afërt po shihet mundësia e botimit, me qëllim mundësimin e shpërndarjes tek një publik dhe më i gjërë si dhe shpërndarjen tek bizneset që mund të ndër marrin hapjen e aktiviteteve që kanë ndikim në mjedis.

## 31 KORRIK - DITA E NDËRKOMBËTARE E RANGERS-VE

Më 31 Korrik të çdo viti festohet Dita e Ndërkombëtare e Rangers-ve (Rojëve të Pyllit) me moton "Mburo natyrën, vepro si një Ranger". Këtë vit kjo nisim u festua për herë të parë edhe në Shqipëri.

Në këtë ditë Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, Administratën e Zonave të Mbrojtura të mbështura nga Bashkimi Evropian, Agjencia Italiane për Bashkëpunim përmes projektit NaturaAL zhvilluan njëkohësisht në 12 rajonet e tyre një fushatë ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e Rangers-ve. Pranë plazheve apo qendrave të qytetit u ngrit një stendë nga ku drejtues, punonjës dhe Rangers-a pranë Administratave të ZM-ve shpërndanë mesazhe për rritjen e ndërgjegjësimit për punën e tyre dhe për promovimin e zonave të mbrojtura në vend.

"Rangers-at mbrojnë natyrën tonë dhe për këtë arsye mbrojnë të ardhmen tonë. Rangers-at nëpërmjet punës së tyre të përditshme mundësojnë ruajtjen e zonave të mbrojtura, zona të cilat realisht ndikojnë në cilësinë e jetës sonë të përditshme", tha Zëvendësministri i Mjedisit, z. Kledi Xhaxhiu, i cili ishte

pjesëmarrës i aktivitetit kushtuar kësaj dite në shëtitoren e qytetit të Durrësit.

Ndërkohë Drejtori i AKZM-së, z. Zamir Dedeq nga stenda e vendosur në shëtitoren e Orikutit tha se: "Festimi i Ditës Ndërkombëtare të Rangers-ave në 12 Zonat e Mbrojtura dëshmon për rëndësinë e ruajtjes së këtyre zonave të cilat paraqesin një rëndësi të veçantë për vendin. Rangers-at tanë luajnë një rol kryesor në mbrojtjen e tyre".

Komunitetet vendore edhe në këtë ditë, mësuan rreth rëndësisë që kanë zonat e mbrojtura për jetën e tyre: Zonat e mbrojtura na sigurojnë ujën, ushqimin, medikamentet dhe ajrin e pastër, ndihmojnë në zvogëlimin e pasojave të përmbytjeve dhe stuhive, ndërsa sigurojnë strehim dhe punësim për vendasit. Rangers-at patrollojnë në zonat e mbrojtura, duke garantuar mbrojtjen nga aktivitetet e paligjshme.

"Nëse ndeshim guetia apo prerje drurësh në mënyrë të paligjshme, është detyra jonë të informojmë drejtuesit, Inspektoriatin e mjedisit apo atë pyjor dhe policinë. Në rast zjarri në pyje ne marim të gjitha masat e nevojshme për shuarjen e tij. Një ranger është në vijën e parë

dhe bën vlerësimin e riskut. Ne gjithashtu monitorojmë kafshët e egra, mbajmë kontakte me komunitetin, me nxënësit e shkollave dhe përpiqemi ti edukojmë dhe ti afrojmë me parkun dhe natyrën. Një ranger shpesh herë shoqëron dhe turistët kur duan të shohin vendet e veçanta që ka një Zonë e Mbrojtur", shpjegon Gëzim Tarja, një prej Rangers-ave të Administratës të ZM-së, Tiranë.

Kjo ditë festohet në 31 Korrik në mbarë botën në përkujtim të shumë rojeve mjedisore të vrarë ose të plagosur në krye të detyrës, për punën që ata bëjnë në ngritjen e vetëdijes në mbrojtje të trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Kjo ditë është një rast shumë i mirë për të ndërgjegjësuar komunitetin si dhe politikëbërësit për të mbështetur punën jetike të Rangers-ave.

Disa prej tyre janë të ekspozuar ndaj kushteve të rrezikshme mjedisore të tilla si përmbytjet apo ndaj kafshëve të egra, të tjerët rrezikojnë jetën e tyre duke u përballur me personat që kryejnë aktivitete të paligjshme, si prerja e drurëve, peshkimi apo guetia e paligjshme.

NË KËTË NUMËR:

REKOMANDIMET E MASTRIHTIT TASHMË NË GJUHËN SHQIPE - FQ.1

31 KORRIK - DITA E NDËRKOMBËTARE E RANGERS-VE—FQ.1

VENDIMET E KOMISIONIT PËR LEJET NË MJEDIS 2016 - FQ.2

MJEDISI NË FORUMIN E MEDIJAVE - FQ.3

"Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe prave në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimi të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përmesushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkëpunuar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenë afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik".

**MIRATOHEN AKTE TË REJA LIGJORE NË FUSHËN E KIMIKATEVE**

Miratohet në muajin Korrik nga Këshilli i Ministrave vendimi “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”. Qëllimi i këtij vendimi është krijimi i një sistemi të detyrueshëm për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve nëpërmjet përcaktimit të:

-kritereve të klasifikimit të kimikateve dhe rregullave mbi ambalazhimin dhe etiketimin e kimikateve të rrezikshme.

-detyrimeve ndaj: (i) prodhuesve, importuesve dhe përdoruesve për të klasifikuar kimikatet që vendosin në treg, (ii) furnizuesve, për etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve; (iii) prodhuesve dhe importuesve të artikujve, për klasifikimin e atyre substancave që nuk janë vendosur në treg, por që janë subjekt i regjistrimit dhe njofimit në përputhje me ligjin në fuqi për menaxhimin e kimikateve.

- listës së harmonizuar të klasifikimit dhe etiketimit të substancave.

- inventarit të klasifikimit dhe etiketimit të substancave.

Përpjesëtimet e këtij akti të sapo miratuar janë mundësimi i zbatimit në praktikë të Rregullores së Bashkimit Evropian 1270/2008. Gjithashtu mjaft e rëndësishme është dhe klasifikimi i kimikateve të rrezikshme, pasi është thelbësor për sistemin e menaxhimit të kimikateve në vendet që aspirojnë të jenë anëtare të BE-së.

Sipas këtij vendimi rreziqet e kimikateve i komunikohen konsumatorit në të gjithë zinxhirin e furnizimit të kimikateve, nëpërmjet etiketës, e cila përmban Deklaratat Standarte dhe Piktogramat e rrezikut si dhe nëpërmjet Dokumentacionit me të dhënat e Sigurisë.

Transpozimi i Rregullores 1272/2008 të BE-së është vendimtare për të siguruar zbatimin në praktikë dhe në kohën e duhur të kërkesave për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve. Si industria edhe administrata duhet të konsiderojnë rëndësinë e këtyre rregullave dhe të arrijnë që jo vetëm të njohin, por edhe të fillojnë të zbatojnë këto rregulla përpara anëtarësimit të vendit të tyre në BE.

Rregullorja 1272/2008 ka miratuar listën e klasifikimit dhe etiketimit, të ashtuquajtur klasifikim i harmonizuar në BE. Kjo listë është pjesë përbërëse e këtij vendimi (shtojca VI). Prodhuesit, importuesit dhe furnizuesit do t'i klasifikojnë kimikatet e rrezikshme bazuar në këtë listë.

Gjithashtu në rastin kur klasifikimi i një substance apo përzierjeje nuk e gjen vendin në këtë listë, në vendim është referuar edhe inventari i ECHA-s (Agjencisë Evropiane të Kimikateve) për klasifikimin dhe etiketimin. Ky inventar nuk është i detyrueshëm, por është një burim shumë i mirë informacioni në

ndihmë të industrisë për qëllime të klasifikimit dhe etiketimit të kimikateve.

Shtojca VI e këtij vendimi i jep industrisë tonë, një listë të gatshme klasifikimesh për t'u përdorur nga ana e tyre. Ato janë klasifikimet e plota të rreth 3000 substancave të cilat kanë pasur një klasifikim të detyrueshëm tashmë nën sistemin e BE-së dhe rreth 1000 klasifikime të substancave që vlerësohen të jenë kancerogjene, mutagjene ose toksike për riprodhimin njerëzor (CMR).

Meqënëse lista dhe Inventari i ECHA-s përmban shumicën e substancave që qarkullojnë sot në treg, prodhuesit, importuesit dhe furnizuesit do t'i referohen këtyre listave për të kontrolluar nëse klasifikimi i kimikatit është i përshtatshëm ose jo. Në rastin e vendit tonë detyrimet mbi klasifikimin e substancave do të prekin shumë pak kompani dhe substanca kimike në treg. Kjo për faktin se shumica e kimikateve që janë të vendosura në treg, gjenden në formën e përzierjeve dhe shumica e kompanive janë furnizues të përzierjeve dhe shumë pak janë furnizues të substancave kimike.

Për këtë arsye, edhe afati kohor për hyrjen në fuqi të dispozitave për substancat, është më i shkurtër se afati i lënë për përzierjet, përkatësisht:

- për substancat që vendosen në treg ose eksportohen nga Republika e Shqipërisë, më 1 Korrik 2018;

- për përzierjet që vendosen në treg ose eksportohen nga Republika e Shqipërisë, më 1 Korrik 2020.

Detyrimet në lidhje me përzierjet hyjnë në fuqi disa vjet më vonë, kur sistemi për klasifikimin e substancave është ndërtuar në praktikë. Kjo bëhet për shkak se industrisë i duhet kohë të aftësohet në klasifikimin e substancave, që të jetë në gjendje për të klasifikuar më vonë edhe përzierjet. Kjo masë lehtëson veçanërisht të kuptuarit dhe të lexuarit e deklaratave të rrezikut dhe deklaratave parandaluese për etiketimin.

Efektet e pritshme të vendimit:

Adresojnë rekomandimet e progres raportit të BE-së në fushën e kimikateve;

Përgatisin industrinë dhe administratën për tu njohur me kriteret për klasifikimin e kimikateve dhe rregullat mbi paketimin dhe etiketimin e kimikateve të rrezikshme si dhe zbatimin e tyre në praktikë përpara antarësimit;

Klasifikimi i kimikateve që vendosen në treg nga prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit profesionalë, kryhet në përputhje me normat që zbatohen sot në BE;

Etiketimi dhe paketimi i kimikateve që vendosen në treg nga

ana e furnizuesve kryhet në përputhje me normat që zbatohen sot në BE;

Aftëson industrinë dhe administratën në përdorimin e Listës së Substancave të Klasifikuara dhe Etiketuara dhe Inventarit të ECHA-s për qëllime të klasifikimit dhe etiketimit të një substance apo përzierjeje substancash;

Konsumatorët, punëtorët dhe përdoruesit profesionalë njihen me klasën e rrezikut të kimikatit, e cila shfaqet në etiketë dhe dokumentin e të dhënave të sigurisë, duke ulur rrezikun e mundshëm në shëndet dhe mjedis;

Plotësojmë kuadrin ligjor në fushën e kimikateve duke krijuar sistemin e menaxhimit të sigurt të tyre.

Po në muajin Korrik u miratua dhe vendimi për “Miratimin e listës së substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (svhc), kritereve për përfshirjen e substancave në listën e svhc dhe lëshimi i një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të svhc”

Substancat që mund të kenë efekte serioze në shëndetin e njeriut dhe në mjedis, identifikohen si substanca me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHCs). Këto substanca, janë substanca me veti mutagjene për qelizat embrionale, kancerogjene, toksike për riprodhueshmërinë (CMR), si dhe me karakteristika të qëndrueshme dhe të bioakumulueshme (PBTs). Substanca të tjera me rrezikshmëri ekuivalente përfshijnë çrregulluesit endokrine.

Ky vendim miratoi listën e SVHC, hyrja në fuqi e së cilës është parashikuar në 1 Tetor 2019. Kjo do të thotë që mbas datës 1 Tetor 2019, ndalohet vazhdimi i vendosjes në treg me qëllim përdorimin e mëtejshëm të SVHC nga prodhuesit, importuesit ose përdoruesit profesionalë.

Përdorimi i këtyre substancave / grupeve të substancave është i lejuar deri më 1 Tetor 2019 ose deri në datën e përcaktuar ndryshe në Shtojcën I të këtij projektvendimi ose kur prodhuesit ose importuesit janë të pajisur me “autorizim të kushtëzuar”, për aq kohë sa kjo datë është brenda periudhës së parantëtarësimit.

Vënia në zbatim e projektvendimit përpara anëtarësimit do ta bëjë më të thjeshtë punën për industrinë vendase dhe administratën për zbatimin e kësaj rregullorjeje. Përndryshe, nëse si afat të ndalimeve përcaktojmë datën e antarësimit në BE, atëherë prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit do të ishin përpara një “goditjeje” nga ndalimi i përgjithshëm i SVHC që kanë në përdorim dhe nuk do të kishin njohurinë e duhur për tu përballur me këtë fakt.

**VENDIMET E KOMISIONIT PËR LEJET NË MJEDIS 2016**

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	VENDIMI	TIPI I LEJES
1	Industria greko shqiptare e foragjereve	Prodhimi i ushqimit për kafshët	Patos, Fier	Refuzim	Tipi B
2	Propan Gas	Magazinin i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisternat e palëvizshme	Bulgarec, Korçë	Miratim	Tipi B
3	Albano	3-II-B: Grumbullim, transportim, ruajtje, asgjësim i mbetjeve urbane	Otlak, Berat	Miratim	Tipi B
4	Habili	Rishikim: Nxjerrja e mineraleve	Lushnjë, Durrës	Miratim	Tipi B
5	Poseidon	Rishikim: Trajtimit magazinim i peshqeve të ngordhur ose mbetjeve të peshqeve	Shëngjin, Lezhë	Miratim	Tipi B
6	Tea shpk	Rishikim: Prodhim i alkoolit dhe pijeve alkoolike	Ish mjediset e kombinatit të	Miratim	Tipi B
7	Tur Alb Krom	Ndryshim: Zonës Minerare 660/5 në 660/6	Kukës	Refuzim	Tipi B
8	Kondi	Furnizim për mbushje gazi GNL	Tepelenë	Miratim	Tipi B
9	Dritarb	Nxjerrja e mineraleve rërës dhe argjilës nga minierat në qiell të hapur dhe nga guroret	Berat, Çorovodë	Miratim	Tipi B
10	Land Fjori Gas	GAZ natyror aromatik ose GNL, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A	Mjediç, Vau i Dejës, Shkodër	Refuzim	Tipi B



*“ Gjatë kthimit tuaj për në shtëpi ...lini gjurmët e këmbëve në rërë, por jo mbetjet ”*

SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT

## MJEDISI NË FOKUSIN E MEDIAVE

### VËNDET E BALLKANIT TË BASHKUARA NË “LUFTËN” KUNDËR MBETJEVE

Lëvizjet e shoqërisë civile për të mbledhur aktivistë për pastrimin e vendeve të tyre në rajonin e ballkanit, është bërë temë për shkrimin e radhës së gazetës prestigjioze “The Guardian”. Në këtë shkrim theksohet se vendet e Ballkanit dikur të ndarë nga lufta, nacionalizmi dhe feja janë bashkuar në heshtje për t'u përbashkuar me një armik të përbashkët: që janë mbetjet.

Nën moton “Pastrojmë Shqipërinë” dhe “Le ta bëjmë këtë”, aktivistët nga Shqipëria dhe nga Kosova kanë pastruar shumë zona të ndotura në vendet e tyre. Sipas “The Guardian” në këto fushata janë përfshirë rreth 5% e popullatës në Shqipëri dhe rreth 7% e tyre në Kosovë. Shqipëria përmendet në këtë shkrim dhe si shteti ballkanik, që e përsërit këtë aksion çdo 6 muaj.

Më mbresëlënëse ka qenë Sllovenia, e cila ka aktivizuar rreth 14% të banorëve të saj për pastrimin e venddepozitimeve ilegale të mbetjeve në vendin e tyre, i cili është cilesuar si aksioni më i madh në këto 4 vitet e fundit. Gjithashtu dhe Rumania ka mundësuar lëvizjen më të madhe kombëtare, që pas revolucionit, me objektiv pastrimin e vendit nga mbetjet.

Në shkrimin e “The Guardian” është vënë re se vetëm Serbia edhe pse e deklaroi fillimin e fushatës për pastrimin e vendit të tyre në vitin 2011, nëpërmjet një konference për shtyp, gjithçka ngeli aty.

Pas iniciativës së parë të kësaj lloji lëvizjeje të shpallur në 2008 nga Estonia, kjo lëvizje “Le ta bëjmë këtë” ka mundësuar mobilizimin e mbi 16 milion aktivistëve në 113 vende. Fushata tjetër e planifikuar në vitin 2018 mendohet se do të ndiqet nga një numër më i madh aktivistësh.

### “KANARINAT” QË PARALAJMËROJNË SHKATËRRIMIN E EKOSISTEMIT

Hulumtimet shkencore thonë se ka disa specie që përmes shtimit apo pakësimit të tyre na mundësojnë vlerësim të gjendjes së përgjithshme të një ekosistemi të tërë dhe parashikim të së ardhmes së tij. Biodiversiteti i planetit Tokë është në rrezik. Do të na duhet të kthehemi pas në kohë mbi 65 milion vjet për të gjetur një përqindje kaq të lartë të specieve të cilat po zhduken, në krahasim me atë çka dëshmojmë sot.

Mbrojtja e specieve të rrezikuara shpesh fokusohet tek kafshët me përmasa të mëdha dhe enigmatike siç janë tigrit, arinjët polarë dhe balenan. Ekzistojnë një mori arsyesh se pse duhen shpëtuar këto specie nga shfarosja/zhdukja, por çfarë mund të themi për shumicën dërrmuese të specieve, që rrallëherë mund t'i vëmë re? Çfarë ndodh me buburrecat dhe krimbat që mund të shfaqen ose të zhduken nga ekosistemet pa ndonjë ndikim të dukshëm?

Biodiversiteti rrit fuqinë ripërtëritëse; më shumë specie do të thotë që çdo specie individuale është në gjendje të përballojë më mirë ndikimet negative. Përfytyroni për një çast degradimin e biodiversitetit si zhvidhosjen e perçinave nga trupi i një avioni. Mungesa e disa perçinave nuk do të shkaktojë shumë dëme, por nëse vazhdohet me heqjen e tyre, atëherë vjen edhe fundi i funksionimit të ekosistemit. Pyjet i lënë vendin shkretëtirës. Shkëmbinjtë koralorë nënujorë zbardhen dhe pushojnë së ekzistuari.

Hulumtimi i ri tregon se biodiversiteti ka një vlerë që është anashkalluar, por mund të jetë me rëndësi jetike në qoftë se jemi në gjendje të menaxhojmë ndikimet tona mbi këto ekosisteme. Studimi i botuar në revistën Ekologjia, tregon se një informacion i rëndësishëm për shëndetin e përgjithshëm apo kthimi në gjendjen e mëparshme të një ekosistemi mund të ketë fshehur të dhëna rreth disa llojeve në dukje të parëndësishme. Në fakt, prania ose mungesa e disa specieve nga më të rrallat, mund të na japë të dhëna të rëndësishme, siç mund të jetë informacioni se sa jemi pranë kolapsit të mundshëm të një ekosistemi.

Këto specie kaq të rralla quhen kanarinat e ekosistemit. Ashtu si kanarinat, që minatorët në minerat e qymyrit i përdorin dikur për të testuar gazrat helmuese në thellësi të tokës, kanarinat e ekosistemeve janë shpesh speciet e para që zhduken nga një ekosistem nën presion. Zhdukja e tyre mund të jetë e lidhur me ndryshimet në funksionimin e ekosistemeve, të cilat mund të shërbejnë si paralajmërim për afrimin e fundit të atij ekosistemi.

Studimi përdor të dhëna të mbledhura nga disa liqene në Kinë, që flasin për ndryshime në lamninë e llojeve në bashkësinë e algave (diatom) dhe disa mizave ujore (chironomid), teksa konkurojnë ndërmjet tyre për të siguruar ushqim nën presione të ndryshme mjedisore. Nga këto të dhëna, u bë e mundur identifikimi i tri lloj

organizmash: Organizma që riprodhohen ngadalë, por tejet luftarake, specie që mund t'i quajmë “gurthemeli”; organizma jo fort konkurruese, por që riprodhohen me shpejtësi, “specie me fuqi riprodhuese si barërat e këqija”; dhe organizma që riprodhohen ngadalë dhe me fuqi të ulët konkurruese, që mund t'i quajmë speciet “kanarina”.

Plehrat kimike që fluturojnë nga fushat përreth kanë një ndikim të madh mjedisor mbi ekosistemet e këtyre liqeneve. Me përqesimin e gjendjes speciet “kanarina” janë viktimat e para. Me vijimin e mëtejshëm të degradimit që ndikon tek të gjitha speciet, arrijmë tek shkatërrimi përfundimtar i specieve “gurthemeli” – specieve me rëndësi jetike, dhe zëvendësimin e tyre me speciet me fuqi riprodhuese si “barërat e këqija”. Zhdukja e specieve “gurthemeli” e fut ekosistemin në një fazë kritike tranzicioni – në pikën kur një sistem ndryshon gjendje dhe liqenet nga njëra anë mbyten nga algat, e nga ana tjetër kemi zhdukjen e shumë specieve të tjera të florës dhe faunës. Ta rikthesh një liqen në gjendjen e mëparshme me ujë të pastër dhe larmi të madhe gjyke është tmerrësisht e vështirë. Shumë më mirë është ta shmangim këtë lloj shkatërrimi sa jemi në kohë.

Nëse rrimë dhe presim për të parë ndryshimet e mëtejshme tek speciet e ashtuquajtura “gurthemeli”, nuk do të na mbetet kohë për të ndërhyrë, pasi sistemi do të kishte marrë të tatëpjetën drejt shkatërrimit përfundimtar. Por nëse studiojmë ndryshimet në strukturën e popullatave dhe raportin mes specieve të rëndësishme jetike, të ashtuquajtura këtu specie “gurthemeli”, atyre me fuqi riprodhuese si “barërat e këqija” dhe specieve “kanarina”, jemi në gjendje që të dallojmë shenja të qarta të shkatërrimit të pritshëm, që mund të jetë pasi disa vitesh apo dekadash. E kështu, kemi kohën e mjaftueshme për të ndërhyrë për të ndryshuar praktikata bujqësore apo praktika të tjera.

Teoria ekologjike që përshkon këtë qasje do të duhet të zbatohet edhe për sisteme të tjera detare apo tokësore. Duke parë shtrirjen dhe shpejtësinë e ndikimit njerëzor mbi mjedisin, nuk do të kishim vështirësi për të gjetur ekosisteme, ku të tilla gjetje do të ishin po kaq me vend.

**Autor James Dyke**

**Lektor i zhvillimit të qëndrueshëm në Universitetin e Southampton-it.**